



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar 26.11.2020			
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	400	5/14/18	



Komuna Glogoc
Opština Glogovac
Municipal Assembly

Duke u bazuar në nenin 19 paragrafi 3, nënparagrafi 3.2 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, lidhur me nenin 22 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores Nr.(QRK) Nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, në shfrytëzim afatëgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme të Komunës së Glogocit, duke vepruar sipas Rekomandimit të Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës 01-Nr.052/03-43188 të datës 09.10.2020 për zgjedhjen e ofertës ekonomike më të favorshme, Vendimin e Kuvendit të Komunës 12-Nr.462/01-47375 dt. 30.10.2020, Konfirmimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glogocit nga Ministria e Pushtetit Lokal Nr.020-828/4 datë 16.11.2020, Kryetari i Komunës lidh kontratë me të cilën përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese:

KONTRATË PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1.

Palët

- 1) Komuna e Glogocit, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, në tekstin në vijim "Autoriteti Kontraktues", dhe
- 2) IP Kos shpk e regjistruar në zyrën e bizneseve në Prishtinë, me zbatimin e ligjit për numrin unik identifikues të biznesit ka këtë NUI: 810834673, Komuna e Prishtinës, e përfaqësuar nga Burim Leci, Drejtor, në tekstin në vijim "Operatori Ekonomik".

Neni 2.

Lënda e Kontratës:

Duke ju nënshtruar kushteve të parashtruara në këtë kontratë, Autoriteti Kontraktues i jep në shfrytëzim afatëgjatë për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite operatorit ekonomik, dhe operatori

ekonomik merr në shfrytëzim afatgjatë nga Autoriteti Kontraktues, parcelën kadastrale Nr.P-70310058-02652-2, pronë shoqërore e Kuvendit të Komunës së Glllogocit.

Neni 3.

Autoriteti Kontraktues është pronar i pronës së paluajtshme komunale të përcaktuar në nenin 1 të kësaj kontrate, në tekstin në vijim e referuar si **“objekti i kontratës”**.

Neni 4.

5.1 Objekti i kontratës është i paradestinuar nga Autoriteti Kontraktues për aktivitete afariste të bizneseve, për përmbushjen e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal. Operatori Ekonomik do të shfrytëzoj objektin e kontratës për qëllime të zhvillimit të aktiviteteve afariste – **ndërtimin Pompë e Derivateve**, sipas projekt propozimit të paraqitur tek Autoriteti Kontraktues dhe kushteve të zhvillimit të projektit.

5.2 Operatori Ekonomik obligohet që ti përmbahet planit dinamik realizues (plani dinamik me 01-Nr.052-50248 të datës 18.11.2020, Vendimi i Kuvendit të Komunës 12-Nr.462/01-47375 datë 30.10.2020, Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit nga Ministria e Pushtetit Lokal Nr.020-828/4 datë 16.11.2020, Njoftimi publik 01-Nr.462/01-38720 datë 16.09.2020 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme komunale, Raporti i vlerësimit të ofertave 01-Nr.052/03-43188 datë 09.10.2020, Njoftimi publik 01-Nr.462/01-43186 datë 09.10.2020, janë pjesë e kësaj kontrate).

5.3 Operatori Ekonomik obligohet të fillojë punën në afat prej 4 muajsh, nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 5.

Operatori Ekonomik obligohet të bëjë pagesën e shfrytëzimit afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës siç është paraqitur në projektin ofertues me nr.01-070-41528, të datës 30.09.2020, në shumën prej 749 mujore.

Neni 6.

6.1. Autoriteti Kontraktues pajtohet t'i ofroj çasje të lirë operatorit ekonomik në objektin e kësaj kontrate, për tërë periudhën e shfrytëzimit të tij.



Neni 7.

Objekti i kontratës

7.1. Autoriteti Kontraktues i'a jep në shfrytëzim pronën Operatorit Ekonomik, ndërsa Operatori Ekonomik e merr në shfrytëzim nga Autoriteti Kontraktues objektin e përshkruar si vijon:

7.2. Fleta poseduese

7.3. Parcela

7.4. Madhësia e tokës

7.5. Të dhëna tjera në lidhje me tokën.

Neni 8.

Kohëzgjatja, vazhdimet dhe anulimi i hershëm:

8.1. Duke iu nënshtruar edhe afateve të tjera të kësaj Kontrate, kohëzgjatja e kësaj Kontratë për dhënen në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës është për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite, që fillon të llogaritet nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

8.2. Në rast të mos realizimit të planit dinamik të kontratës për dhënen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke tejkaluar afatet e përcaktuara me kontratë, Kryetari i Komunës e ka të drejtën e marrjes vendimit për shkëputjen e kontratës. Më këtë vendim njoftohet Kuvendi i Komunës.

8.3. Në rast të evidentimit të shkeljes së kontratës apo shmangies nga qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës nga shfrytëzuesi, kryetari i komunës obligohet që në çdo kohë të njoftoj Kuvendin e Komunës me shkrim, së bashku me rekomandimin e tij për shkëputje të kontratës apo masat e caktuara ndaj shfrytëzuesit.

8.4 Nëse Operatori Ekonomik nuk e plotëson ndonjë kusht paraparak, Autoriteti Kontraktues mund të anulojë këtë Kontratë, duke e njoftuar me shkrim Operatorin Ekonomik për këtë dhe të kërkoj dëmshpërblimin sipas dispozitave ligjore në fuqi.



8.5. Operatori Ekonomik ka të drejtë që, në diskrecionin e tij të vetëm dhe të plotë, gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, ta anulojë këtë Kontratë para datës së përfundimit të saj pa ndonjë kërkesë për dëmshpërblim, duke e njoftuar me shkrim Autoritetin Kontraktues për synimin e tij për ta anuluar këtë Kontratë. Operatori Ekonomik duhet ta njoftojë Autoritetin Kontraktues me shkrim së paku 60 (gjashtëdhjetë) ditë para datës më të cilën synon ta anulojë këtë Kontratë.

Neni 9.

9.1 Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës.

9.2 Kryetari i Komunës obligohet që ta njoftoj Kuvendin e Komunës pas përfundimit të çdo kontrate të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke përshkruar gjendjen aktuale të pronës, si dhe të jap propozimet për destinimin e saj në të ardhmen.

9.3. Pas përfundimit të kontratës për shfrytëzimin afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës, mund t'i vazhdohet afati në bazë të performancës.

Neni 10.

Mbikëqyrja e kontratave:

10.1. Komuna mbikëqyrë realizimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas planit dinamik realizues.

10.2. Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore ti paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim.

Neni 11.

Operatori Ekonomik obligohet ti përmbahet vendimit të Kuvendit të Komunës 12-Nr.462/01-47375 i datës 30.10.2020, si dhe me projektin ofertues me nr.01-070-41528, të datës 30.09.2020, në



rastë të mos përmbushjes së tyre Kryetari i Komunës ka të drejtë ta shkëpus kontratën në mënyrë të njëanshme.

Neni 12.

Operatori Ekonomik obligohet që pas nënshkrimit të kësaj kontrate, ti përmbahet afatit të paraparë në planin dinamik, të përgatisë të gjithë infrastrukturën e nevojshme ligjore për fillimin e punimeve, duke siguruar shfrytëzimin apo destinimin e saj në të mirë dhe interes të përgjithshëm.

Neni 13.

Kontestet eventuale lidhur me këtë kontratë, kontraktuesit do ti zgjidhin me mirëkuptim dhe marrëveshje, dhe në rast se këtë nuk mund të arrijnë atëherë kontestet do të zgjidhen në Gjykatën Kompetente.


Neni 14.

Kjo kontratë është përpiluar në ekzemplar të mjaftuar për palën kontraktuese, palët kontraktuese e kanë lexuar dhe kanë kuptuar përmbajtjen e kësaj kontrate, dhe në shenjë të pajtimit të vullnetit të tyre e nënshkruajnë pa vërejtje.

Neni 15.

Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrim nga ana e palëve kontraktuese.

Kryetari i Komunës
z. Ramiz Lladeci



IP Kos shpk
z. Burim Leci

